

~T'JA NISËSH EDHE NJËHERË NGA E PARA!~



"Ndihem me fat sepse të gjitha gjërat që dëshiroja po i realizoj pak nga pak. Kam pasur një mbështetje shumë të madhe që më ka bërë të eci përpara dhe të besoj tek vetja"

– shprehet Ana me buzë në gaz dhe plot besim.

Procesi riintegrues i Anës mundësohet nga:

"Reduktimi i vulnerabilitetit ndaj trafikimit dhe riintegrimi i vikimave dhe atyre në rrezik të lartë trafikimi nëpërmjet zgjidhjeve me bazë komunitare dhe aksesit në shërbime sociale"
pjesë e projektit multi-partner "Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria"

Mbështetur nga "UNICEF Shqipëri"



Pasi i mbijeton një situatë të vështirë trafikimi Ana rikthehet në Shqipëri. I duhej kohë të ambjentohej, të kuptonte që tashmë ishte e sigurt dhe që gjithçka që kishte kaluar i përkiste vetëm të shkuarës. Rikthimi në vendlindje për të nuk ishte vetëm një zhvendosje. Ishte një rikthim për të rivazhduar gjërat që ajo dikur kishte lënë në gjysëm, me shpresën për të pasur një jetë më të mirë jashtë Shqipërisë.

Tashmë kishte nevojë për ndihmë, ndaj në përgjigje të nevojave të saj u bë pjesë e programit të riintegritit të organizatës "Të Ndryshëm & Të Barabartë". Pasi ju ofruan shërbimet parësore dhe të menjëhershme, një nga prioritetet e saj ishte mbështetja për vazhdimin e shkollës. Duke u bazuar në nivelin e saj arsimor ajo u inkurajua për të vazhduar studimet e larta. Kishin kaluar vite që prej kohës që kishte mbaruar gjimnazin dhe e vuante faktin që nuk kishte mundur t'a vazhdonte shkollën. Ëndrra e saj më e madhe ishte të konkuronte dhe të fitonte dhe degën e saj të preferuar. Ndaj për të bërë të mundur këtë gjë "D&E" u angazhua në përgatitjen e dokumentacionit për të aplikuar në fakultet.

Me mbështetjen e plotë të stafit multidisiplinar ajo arriti të konkuronte dhe të fitonte universitetin. Më pas u asistua mbi procedurat e regjistrimit, u mbështet me librat dhe mjetet mësimore të nevojshme. Për t'a lehtësuar, një ndihmesë e madhe për të ka qënë edhe pagesa e tarifës vjetore të fakultetit. Tashmë ajo frekuenton shkollën rregullisht dhe ndihet entuziaste për rezultatet e larta.

Paralelisht me arsimimin, Ana është mbështetur edhe në hapjen e biznesit të saj ku ajo ka mundur të gërshetojë me sukses sipërmarrjen me shkollën.

